



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 1356 Prot.

Gjirokastër, më 05/11/2020

VENDIM

Nr. 35 datë 05.11.2020

PËR RIFILLIMIN E STUDIMEVE PËR STUDENTËT QË I KANË PEZULLUAR

Në mbështetje të: ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 90, pika 1 "Kohëzgjatja e studimeve" dhe neni 97, pika 2 "Fillimi, pezullimi dhe humbja e statusit të studentit"; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", neni 51, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, në mbledhjen e tij të datës 05.11.2020,

VENDOSI

1. Studentët që i kanë pezulluar studimet, pavarisht nga periudha e shkëputjes, kanë të drejtë, me kërkesën e tyre dhe miratimin e njësive kryesore, t'i rifillojnë ato.
2. Kohështrirja e studimeve para pezullimit dhe pas rifillimit, të mos e kaloj dyfishin e kohëzgjatjes normale të studimeve.
3. Për kontigjentet e studentëve që nuk janë paisur me numur matrikullimi të aplikohet pranë QSHA-së.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK


Prof.dr.Bektash MEMA

